

EDVINA SOJATI

**SINTAGMA MBIEMËRORE NË DISA VEPRA TË LETËRSISË
BASHKËKOHORE**

Analizat e dukurive sintaksore të gjuhës shqipe në kuadër të teorive të sintaksës gjenerative vitet e fundit kanë marrë një shtrirje të gjerë, duke rrokur një sërë dukurish të sintaksës, morfologjisë dhe të semantikës dhe duke u dhënë kështu zgjidhje disa çështjeve që në sintaksën tradicionale shpesh janë lënë në hije. Studimet në kuadër të gjenerativizmit i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë sintagmës, veçanërisht asaj emërore dhe parafjalore, duke nxjerrë në pah veçoritë dhe specifikat e saj. Për ta plotësuar sadopak analizën e sintagmës së shqipes, në këtë artikull, do të analizojmë strukturën e sintagmës mbiemërore në disa vepra të letërsisë bashkëkohore, duke u përqendruar në problematika të tilla si vendi që ajo zë në sintagmën më të madhe ku shfaqet, dhe funksionin që kryen. Për të vënë në pah lidhjet midis përbërësve, do të përdorim paraqitjen skematike me anë të teorisë x-bar.

Sintagma mbiemërore (SM) është ajo sintagmë që ka si kokë një mbiemër. Mbiemri si kategori leksikore ka aftësinë të modifikojë emrin brenda një sintagme emërore apo determinative (SD), por edhe të jetë kokë e një sintagme. Një sintagmë mbiemërore shfaq ngjashmëri të mëdha nga pikëpamja strukturore me llojet e tjera të sintagmave: ka një kokë, specifikues dhe komplement. Edhe ajo ka tri nivele projektimi: projektionin zero (M^0), i cili përfaqësohet nga koka, e cila nuk mund të mungojë dhe në këtë pozicion del mbiemri; projektionin e ndërmjetëm (M'), që përfaqësohet nga koka dhe komplementi¹ dhe projektionin maksimal (SM) që ndërtohet nga specifikuesi dhe projektioni i ndërmjetëm M' . Nisur nga shembujt e analizuar nga letërsia artistike, është vënë re se SM-ja realizohet në mënyra të ndryshme. Këto sintagma mund të jenë të thjeshta, pra kanë vetëm kokën, ose të zgjeruara, që përveç kokës kanë edhe komplement, ose kokën dhe specifikuesin, ose të tria këto elemente njëkohësisht: kokë, specifikues dhe komplement.


(1)

(a) Djali, *i lodhur*, u shtri nën hijen e pemës.

¹ Disa studiues përdorin termin *plotësor*.


- (b) Djali, *shumë i lodhur*, u shtri nën hijen e pemës.
 (c) Djali, *i lodhur nga rruga*, u shtri nën hijen e pemës.
 (d) Djali, *shumë i lodhur nga rruga*, u shtri nën hijen e pemës.

Në fjalinë (1a) sintagma mbiemërore ka vetëm kokën, *i lodhur*; në fjalinë (1b) ka kokën *i lodhur* dhe specifikuesin *shumë*; në fjalinë (1c) kokën *i lodhur* dhe komplementin *nga rruga*, kurse në fjalinë (1d) i ka të tri këto elemente: kokën, specifikuesin dhe komplementin. Veçoritë e sintagmës mbiemërore të shqipes lidhen ngushtë me natyrën e mbiemrit. Kështu, skema e një SM-je që ka si kokë një mbiemër të nyjshëm, është e ndryshme nga skema e një SM-je që ka si kokë një mbiemër të panyjshëm. Skema x-bar e sintagmës që ka si kokë vetëm një mbiemër të panyjshëm, është: [SM [M' [M⁰ trim]]].




Por kjo skemë nuk e paraqet plotësisht strukturën e një mbiemri të nyjshëm, sepse nuk e përcakton pozicionin e nyjës, e cila kërkon një vend të veçantë në brendësi të sintagmës mbiemërore. *Cili është vendi i nyjës në skemën X-bar? A ka aftësinë nyja e mbiemrit të jetë kokë e një sintagme?* Abney, në “The English Noun Phrase in its Sentential Aspect”, pohon se kokë e një sintagme emërore mund të jetë edhe një kategori funksionale. Pra, sintagma nuk formojnë vetëm kategoritë leksikore të sipërpërmendura, por edhe kategoritë joleksikore, që ndryshe njihen si kategori funksionale dhe këtu përfshihen: nyjat, përemrat dëftorë, pyetës, të pacaktuar, pronorët e paravendosur, sasioret dhe numërorët. Sintagmat që kanë kokë një kategori funksionale, janë quajtur sintagma determinative. Por a formon nyja e mbiemrit një sintagmë të tillë? A i ka ajo veçoritë për të qenë kokë e një sintagme determinative? Nëse po, cili është vendi i saj në skemën X-bar? G. Turano pohon se “hipoteza më e pranueshme është ajo sipas së cilës kjo nyjë gjenerohet në një pozicion D⁰, prandaj projeksioni maksimal

i këtyre mbiemrave nuk është ai i një sintagme AP², por i një sintagme determinante mbiemërore DP_{Adj} = Adjective DP³.” Nisur nga kjo hipotezë, struktura e brendshme e një sintagme mbiemërore që ka vetëm kokën (një mbiemër të nyjshëm), do të jetë: [SD_M [D⁰ i] [SM [M' [M⁰ mësuar]]]].



Kurse sintagma *shumë i lodhur nga rruga*, që ka si kokë mbiemrin *i lodhur*, specifikues ndajfoljen *shumë* dhe komplement sintagmën parafjalore (SP) *nga rruga*, do të paraqitet kështu: [SD_M [Spec shumë] [D'_{Mb} [D⁰ i] [SM_b [Spec] [M' [M⁰ lodhur] [SP nga rruga]]]]].



² G. Turano përdor shkurtime sipas terminologjisë anglisht, pra AP qëndron për *Adjective Phrase* – sintagmë mbiemërore (SM).

³ F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Tiranë, 2011, f. 75.


Por kur mbiemri është në numrin shumës, ç'vend do të zërë nyja dhe ç'vend do të zërë prapashtesa e shumësit? Një tjetër veçori e mbiemrit në gjuhën shqipe, ndryshe nga anglishtja dhe italishtja, është se ai përshtatet në gjini, numër dhe rasë me emrin që përcakton. Si rrjedhim, pëson ndryshime në strukturën e tij. Në këtë rast, për mbiemrin e nyjshëm në gjininë mashkullore në numrin shumës, kjo nuk përbën ndonjë problematikë, sepse i ndryshon vetëm nyja nga *i* në *të* dhe skema e mësipërme vlen edhe për këto sintagma mbiemërore.

(2)

Ata djem janë shumë të lodhur nga rruga.

Sintagma mbiemërore *shumë të lodhur nga rruga* skematikisht do të paraqitej:

[SD_M [Spec shumë] [D'_M [D⁰ të] [SM [Spec] [M' [M⁰ lodhur] [SP nga rruga]]]]].




Problematicë në këtë rast shfaq mbiemri i nyjshëm në gjininë femërore, i cili, përveç nyjës së përparme, ka edhe prapashtesën e shumësit. Pra, na dalin dy determinantë: nyja e përparme dhe nyja e prapme (prapashtesa e shumësit). Ç'pozicion mund të zërë në skemën x-bar njëra apo tjetra?

(3)

Ato vajza janë shumë të lodhura nga rruga.

Skema e mësipërme nuk është e përshtatshme, për fjalinë (3), prandaj nevojitet që të shtojmë një kategori shtesë në skemë, atë të përshtatjes⁴. Kjo kategori qëndron midis nyjës SM dhe nyjës D'_M. Sintagma *shumë të lodhura nga rruga*, me futjen e kësaj kategorie, do të paraqitet: [SD_M [Spec shumë][D'_M [D⁰ të][AgrP [Spec][Agr' [Agr⁰ lodhur -a][SM [Spec][M' [M⁰ lodhur][SP nga rruga]]]]]]].



Pra, nyja e përparme vazhdon të qëndrojë në pozicionin e saj D⁰, kurse prapashtesa e shumës në pozicionin Agr⁰, së cilës, nëpërmjet operacionit të lëvizjes (lëviz α), i bashkëngjitet edhe mbiemri, i cili nga pozicioni M⁰, ngjitet në atë Agr⁰, duke lënë një gjurmë t në pozicionin fillestar.


Kjo kategori është e nevojshme edhe për sintagmën mbiemërore me kokë një mbiemër të panyjshëm.

(4)

Ata djem janë *trima*.

[AgrP [Spec][Agr' [Agr⁰ trim -a][SM [Spec][M' [M⁰ trim]]]]]

⁴ Në anglisht *Agreement – Agreement Phrase (AgrP)*. Këtë term do të përdorim në skemat e sintagmave mbiemërore.



Struktura e sintagmës mbiemërore

Elementet përbërëse të një sintagme mbiemërore janë specifikuesi, koka dhe komplementi.

Specifikues të sintagmës mbiemërore

Specifikues të një SM-je janë *ndajfoljet që tregojnë shkallën e mbiemrit*. Mbiemri është ajo pjesë e ligjëratës që ka si cilësi edhe kategorinë e shkallës dhe në këtë pikë është i ngjashëm me kategorinë e ndajfoljes, se edhe ajo e mbart këtë tipar. “Shkalla e mbiemrit shpreh masën në të cilën shfaqet një cilësi e caktuar të sendi i dhënë⁵.” Por jo të gjithë mbiemrat kanë shkallë. Këtë tipar e zotërojnë vetëm ata mbiemra cilësorë, semantika e të cilëve u lejon që tipari i emërtuar prej tyre të shprehet në masë të ndryshme. Në këtë grup bëjnë pjesë ndajfoljet e barazisë, pabarazisë, ultësisë dhe të sipërisë.

- Në grupin e parë, ndajfoljet e barazisë, përfshihen ndajfoljet *aq*, *kaq*, *sa* (*sa e vështirë*) dhe ndiqen nga lidhëza e krahasimit *sa ose si*: *kaq e pabesueshme sa mund të kishte...*
- Te ndajfoljet e pabarazisë bëjnë pjesë ndajfoljet përforcuese, si: *më*, dhe ndiqen nga lidhëza *se, sesa, nga*: *më e zgjuar nga unë*.
- Në grupin e tretë është ndajfolja *pak*: *pak i zgjuar, shumë pak i zgjuar*.
- Në këtë grup bëjnë pjesë ndajfolje që tregojnë sasi, si: *shumë, jashtëzakonisht, mjaft, tepër, fort, krejt, fare, absolutisht* dhe disa

⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Tiranë, 2002, f. 172.

ndajfolje përforcuese: *thellësisht, tmerrësisht, çuditërisht, etj.: jashtëzakonisht i bukur.*

Specifikues të SM-së mund të jenë edhe disa emra të cilët nuk emërtojnë më sendet, por një nga tiparet më karakteristike të këtyre sendeve, të cilin e kanë në një shkallë shumë të lartë. Këta emra që e kanë humbur kuptimin e tyre, quhen *emra me kuptim të fyturuar*. Të tillë janë: *akull, qumësht, pisë, flakë, mjaltë, borë, prush, qiqër, thanë, etj.: akull i ftohtë, mjaltë i ëmbël, pisë i zi etj.*

Specifikues mund të jetë edhe një pjesëz: *ç'e madhe poshtërsi, aspak i kotë etj.*

Komplemente të sintagmës mbiemërore

Komplement i sintagmës mbiemërore mund të jetë një *sintagmë parafjalore*: i gjatë nga shtati, i aftë në muzikë, i rreptë ndaj shkeljeve, i duruar me fëmijët, të zbehura nga largësia, i rrethuar nga zona të gjera, i ngjashëm me tundimin etj.

Një *sintagmë emërore*: më e para përmendore, i shkreti djalë, më i gjati i klasës.

Një *formë e pashtjelluar* – *paskajorja*: i pafuqishëm për të bërë përpara.

Një pjesëz: Të qetësuar **disi**, njerëzit filluan të shfaqnin mendime për fletushka.

Një *sintagmë lidhëzore* (fjali argumentuese: kundrinore, kryefjalore): Kjo s'ishte e vështirë të vërtetohej; i pafuqishëm që të bënte përpara; një fjali krahasore: *Mirëpo ky qytet ishte ose më pak, ose më shumë i mençur se ç' duhej*, çka në fund të fundit ishte e njëjta gjë; më i madh sesa e kishte menduar.

Vendi i sintagmës mbiemërore në strukturën e përbërësit më të madh në të cilin ajo del dhe funksionet e saj

Sintagma mbiemërore del në pozicione të ndryshme në fjali dhe në varësi të pozicionit në të cilin ajo shfaqet, përcaktohet dhe funksioni i saj.

Kështu, gjatë analizave të kryera kemi vënë re se SM-ja në strukturën e sintagmës më të madhe në të cilën ajo del, mund të jetë:

Modifikues pasemëror i sintagmës emërore: djalë i bukur.

Modifikues i një sintagme tjetër mbiemërore: të bardhë të bardhë.

Specifikues i kategorisë *Focus* në sintagmën emërore: të bukura fjalë, e gjora nënë, trim djalë etj.

Komplement i sintagmës foljore: kërcënimet me hedhje në erë e të tjera si ato **ishin dukur** të vjetra e pavend; pamja **ishte** tejet paqësore; **ishte** më e lehtë të lexoje...

SM-ja që është modifikues i një sintagme emërore, në skemën X-bar, del në të djathtë të kokës, pra, në pozicionin e komplementit. *Çfarë mund të drejtojë një mbiemër kur është kokë e sintagmës mbiemërore?* Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, së pari, duhet të dimë nëse mbiemrat kanë valencë. Fillimisht, teoria e valencës e studiuesit frëng L. Tesnière është zbatuar vetëm për foljet, por më vonë u shtri edhe te dy klasa të tjera, ajo e emrave dhe e mbiemrave. F. Koleci thotë se “edhe mbiemrat mund të kenë strukturë argumentore”. Ajo pohon se në sintagmën mbiemërore *i aftë për punë*, mbiemri është njëvalentësh dhe përzgjedh SP si plotësues⁶. Ashtu si folja, edhe mbiemri ka nevojë t'i shkarkojë rolet tematike te sintagma që drejton, zakonisht një SP ose një SE. Kështu që edhe mbiemrat kanë valencë. Nga ana tjetër, shtrohet pyetja: *A mund të jenë mbiemrat, përkatësisht sintagmat mbiemërore, argumente?* G. Graffi thotë se “që mbiemrat nuk janë argumente është mjaft e qartë, sepse prania e tyre nuk kërkohet detyrimisht nga një emër, apo nga një folje⁷”. Ai pohon se prania e një modifikuesi nuk është e detyrueshme, por fakultative.

(5)

- a) Fëmijët *e vegjël* po luajnë në oborr.
- b) Fëmijët po luajnë në oborr.

Siç shohim dhe nga shembulli, sintagma mbiemërore nuk është e detyrueshme. Edhe pasi është hequr, fjalia është sërish gramatikore.

Po cili është funksioni i sintagmës mbiemërore në këto struktura?


SM-ja në këtë pozicion del në *funksion atributiv* (cilësor, përcaktor) dhe gjen një përdorim mjaft të dendur, sepse lidhet me veçoritë leksiko-semantike të mbiemrit për të emërtuar cilësinë e një sendi, frymori ose vetinë e një gjendjeje të emërtuar nga një frymor a send. Mbiemri del në funksion atributiv kur modifikon kokën e një sintagme emërore⁸. P.sh.: *lumë i vogël, plak mjekërbardhë, nuset më të bukura, më të shpejta, gjarpër i zi* etj. Edhe pse pozicioni më i zakonshëm i këtij modifikuesi në gjuhën shqipe është ai pasemëror, në dallim nga italishtja apo anglishtja, ku modifikuesi i kokës së SE-së i shprehur me një SM, është një modifikues paraemëror, dalin edhe struktura kur SM-ja del para emrit-kokë.

⁶ F. Koleci dhe G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, shblu, Tiranë, 2011, f. 34.

⁷ G. Graffi, “Sintaksa, Strukturat e ligjëritimit”, Dituria, Tiranë, 2003, f. 153.

⁸ R. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, J. Svartvik, *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, 1985, f. 417.

Këto janë ndërtime stilistike, ku SM-ja shfaqet në të majtë të kokës që modifikon, dhe shqiptohet me një intonacion më të fortë: *djali i varfër / i varfri djalë, vajzë e bukur / e bukura vajzë, fjalë të bukura / të bukura fjalë, nënë e gjorë / e gjora nënë, djalë guximtar / guximtari djalë* etj. Në këto përdorime, mbiemri emërzohet dhe merr tipare të kategorisë së shquarsisë, por tiparet e gjinisë dhe të numrit i merr sërish nga emri që përcakton. Në të tilla ndërtime, mbiemri mbart tipare të kategorisë *Focus*. Në projeksionin FocusP, mbiemri do të zërë pozicionin e specifikuesit⁹.
[FocP [Spec guximtar][Foc' [Foc⁰][NumP [Spec][Num' [Num⁰ djalë][SE [E⁰ djalë]]]]]]



Por ka disa emra dhe mbiemra të cilët, nisur nga semantika e tyre, e kanë të nevojshme shkarkimin e roleve tematike tek argumentet e fjalisë. Prania e sintagmës mbiemërore në këtë rast është e detyrueshme dhe ajo nuk mund të hiqet, në të kundërt, fjalia bëhet jogramatike.

(6)

⁹ Sh. Rrokaj dhe G. Turano, *A proposito del sintagma nominale in albanese* në “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007, f. 65.

- a) Doktor Gurametoja i madh jo vetëm që ishte *më hijerëndë e më i madh* në moshë se tjetri...
- b) *Doktor Gurametoja i madh jo vetëm që ishte në moshë se tjetri...

Këto sintagma mbiemërore në struktura të tipit [jam + SM] dhe [folje + SM] në fjali dalin si komplement i një sintagme foljore dhe qëndrojnë në të djathtë të kokës së SF-së. Sintagmat që dalin në këtë pozicion, kryejnë *funksion predikativ* (të kallëzuesit emëror dhe të përcaktorit kallëzuesor). Edhe në vetvete, ky funksion ka disa specifika që lidhen me natyrën semantike të foljes që qëndron para SM-së.

Struktura [jam + SM] – *Ajo që dëgjohej, ishte kaq e pabesueshme, saqë mund të kishte lidhje vetëm me shprehjen e thënë prej dikujt...*

Në struktura të tipit [folje + SM], ekziston një lidhje e dyanshme: nga njëra anë me foljen dhe nga ana tjetër me kryefjalën ose kundrinën, prandaj kemi predikativ të kryefjalës dhe predikativ të kundrinës së drejtë¹⁰. P.sh.: *Ithtarët quheshin të luajtur, por kjo s'pengonte që shpresa se pengjet do të liroheshin krejt gjer në mesnatë, të përhapej gjithkund.*

Pra, SM-ja del në dy funksione sintaksore: atributiv dhe predikativ. Por a shfaq kufizime një sintagmë mbiemërore kur del në njërin funksion ose tjetrin? Ranko Matasovič thotë se “në shumë gjuhë, shfaqen kufizime lidhur me përdorimin atributiv të një SM-je. Kufizimet lidhur me përdorimin predikativ të kësaj sintagme janë më pak të zakonshme ose nuk ekzistojnë. Nëse një sintagmë mbiemërore AP në një gjuhë L përdoret në funksion atributiv, atëherë mund të përdoret edhe në funksion predikativ, por jo anasjelltas¹¹.” Një dukuri të tillë e vë re edhe për shqipen në shembullin që sjell:

(7)

- a) Ai është *krenar* për punën e vet. (predikativ)
- b) *Babai *krenar* për punën e vet. (atributiv)

Përfundime

Sintagmat mbiemërore në gjuhën shqipe janë sintagma që kanë si kokë një mbiemër të nyjshëm ose të panyjshëm. Kur kokë e sintagmës është një

¹⁰ Në “A Comprehensive Grammar of English Language” thuhet se mbiemrat janë kallëzuesorë kur funksionojnë si plotës i kryefjalës ose kundrinës. Këtu është një marrëdhënie e ngjashme mes plotësit të kryefjalës dhe kundrinës:

The children are *happy*. Fëmijët janë të lumtur.

He seems *careless*. Ai duket i kujdesshëm

¹¹ R. Matasovič, *Adjective phrases*, f. 7 në <http://linguistics.buffalo.edu/people/faculty/vanvalin/rrg/Matasovic.pdf>

mbiemër i nyjshëm, projeksioni maksimal i kësaj sintagme është ai i një sintagme determinative mbiemërore (SD_M) dhe nyja gjenerohet në pozicionin D^0 . Kur kokë është një mbiemër i nyjshëm në gjininë femërore dhe numrin shumës, në skemën X-bar shtohet kategoria e përshtatjes, që në skemë zë pozicionin mes nyjës D'_M dhe SM. Gjithashtu, kjo kategori është e nevojshme edhe kur mbiemri është i panyjshëm dhe në shumës. Sipas pozicionit në të cilin shfaqet, SM-ja mund të jetë modifikues pasemëror i SE-së, specifikues i një tjetër SM-je apo i kategorisë *Focus* në SE dhe komplement i sintagmës foljore.

Në disa struktura, sintagma mbiemërore nuk është e domosdoshme dhe mund të hiqet e fjalja të sërish mbetet gramatikore, kurse në disa të tjera prania e saj është e detyrueshme. Sintagmat mbiemërore që nuk janë të domosdoshme në fjali, dalin në funksion atributiv, kurse sintagmat prania e të cilave është e detyrueshme, dalin në funksion predikativ.

Problematika e sintagmës mbiemërore të shqipes është shumë e larmishme për vetë natyrën e mbiemrave dhe në këtë trajtesë të shkurtër kemi prekur vetëm disa çështje të saj, lidhur me strukturën dhe funksionet e saj.

BIBLIOGRAFI

- Abney, S., *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*, MIT, 1987.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Tiranë.
- Graffi, G. (2003), *Sintaksa, Strukturat e ligjërit*, Dituria, Tiranë.
- Koleci, F. dhe Turano, G. (2011), *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
- Memushaj, R. (2004), *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë.
- Memushaj, R. (2008), *Gjuhësia gjenerative*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
- Matasovič, R., *Adjective phrases*, <http://linguistics.buffalo.edu/people/faculty/vanvalin/rrg/Matasovic.pdf>
- Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J. (1985), *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman.
- Rrokaj, Sh., Turano, G. (2007), *A proposito del sintagma nominale in albanese*, në “Çështje të gjuhës shqipe”, Albatros, Tiranë.

